



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:181524

Datë: 22.04.2024

Numri i dokumentit: 05600622

P.nr.2592/20

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Dibran Jusufi, me bashkëpunëtoren profesionale Sadete Kuqi Berisha në çështjen penale kundër të pandehurit S.K., i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë - PP.II.nr.510/20 të datës 08.12.2020, për veprën penale – Vjedhje nga neni 313 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur lidhur me Marrëveshjen për Ndërmjetësim me shifrën Nd.nr.211/24 të datës 05.04.2024, e lidhur në Zyrën për Ndërmjetësim në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në mes të pandehurit S.K. dhe të dëmtuarit A.N., konform nenit 357 par.1.3 të KPPRK-së lidhur me nenin 14 të Ligjit për Ndërmjetësim nr.06/L-009, më datë 22.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET Marrëveshja për Ndërmjetësim me shifrën Nd.nr.211/2024 të datës 05.04.2024, e lidhur në Zyrën për Ndërmjetësim në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në mes të pandehurit S.K. në njërin anë dhe të dëmtuarit A.N., në anën tjetër.

HEDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.510/20 të datës 08.12.2020 dhe PUSHON procedura penale kundër të pandehurit S.K., për shkak të veprës penale Vjedhje nga neni 313 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.510/20 të datës 08.12.2020, kundër të pandehurit S.K., për shkak të veprës penale Vjedhje nga neni 313 par.1 të KPRK-së.

Në seancën e datës 05.04.2024, i pandehuri dhe pala e dëmtuar kanë shprehur gatishmërinë dhe vullnetin e tyre për referimin e lëndës në ndërmjetësim. Gjykata ka kërkuar edhe mendimin e Prokurorit të shtetit Rrahim Podvorica, i cili duke vlerësuar se plotësohen kushtet ligjore për ndërmjetësim, është pajtuar me propozimin e palëve.

Pas propozimit të palëve, duke vepruar konform nenit 2 paragrafi 1 dhe 2 dhe nenit 8 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Ndërmjetësim nr. 06/L-009, u vendos që lënda të dërgohet në Zyrën për Ndërmjetësim në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Me datë 05.04.2024 në Zyrën për Ndërmjetësim në Prishtinë është arritur marrëveshja Nd.nr.211/24, në mes të palës së dëmtuar dhe të pandehurit.

Gjykata vlerësoi se marrëveshja për ndërmjetësim pasqyron vullnetin e lirë të palëve dhe është e lidhur në pajtim me ligjin andaj duke vepruar në pajtim me nenin 15 par.1 të Ligjit mbi Ndërmjetësim nr. 06/L-009, me datë 22.04.2024 e aprovoi këtë marrëveshje, e cila pas aprovimit nga Gjykata, përkatësisht nga data 22.04.2024 kjo marrëveshje ka fuqinë e titullit ekzekutiv.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u mor konform nenit 454 par. 1 të KPPRK-së.

Nga se u tha më lartë konform nenit 357 par. 1 pika 1.3 të KPPRK-së lidhur me neni 15.1 të Ligjit për Ndërmjetësim nr.06/L-009, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM ,
DIVIZIONI PENAL
P.nr.2592/20, dt.22.04.2024

Gj y q t a r i

Dibran Jusufi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar Ankesa.